

TESTI I PËRPUTHSHMËRISË

FAKTORËT KRYESORË PËR MBARËVAJTJEN E
VEPRIMTARIVE TREGTARE PRIVATE

STATUTI I KOMPANISË

Për të drejtën tregtare dhe jetën në biznes, statuti mund të cilësohet si akti kushtetues i kompanisë. Përmes tij, rregullohen aspektet themelore, mbi të cilat ngrihet dhe mbështetet ekzistenca dhe mbarëvajtja e një kompanie.

Në të rregullohen gjithashtu elemente të caktuara, të cilat nuk normohen shprehimisht nga ligji, apo nuk përmenden fare në këtë të fundit.

Statuti duhet të jetë në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi, që kanë për objekt normimin e shoqërive tregtare.



Në veçanti, statuti hartohet duke marrë parasysh kërkesat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”.

Gjithashtu, për formën aksionare të shoqërive tregtare statuti duhet të mbështetet edhe në parimet e Kodit të Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Aksionare jo të Regjistruara në bursë, në mënyrë që të garantohen elementë të tillë si:

- (i) mbrojtja e aksionarëve,
- (ii) respektimi i të drejtave të punëmarrësve apo grupeve të tjera të interesit,
- (iii) vendimmarrje e drejtë,
- (iv) transparencë në vendimmarrje,
- (v) organe efektive, etj.

Sipas ligjit *për regjistrimin e biznesit*, shoqëritë tregtare regjistrohen në regjistrin tregtar, duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme, statutin dhe aktin e themelimit, në rast se janë hartuar si dy dokumente të veçanta, aktet e emërimit të organeve të shoqërisë, nëse nuk përfshihen në aktet e mësipërme, si dhe aktet e tjera të nevojshme për themelimin, sipas legjislacionit në fuqi.

STATUTI I SHOQËRIVE TREGTARE DUHET TË PËRMBAJË DHE TË IDENTIFIKOJË MIRË TË DHËNAT E MËPOSHTME:

- A. EMRI;**
- B. FORMA;**
- C. DATA E THEMELIMIT;**
- D. TË DHËNAT E IDENTIFIKIMIT TË THEMELUESVE;**
- E. SELIA;**
- F. OBJEKTI, NË QOFTË SE ËSHTË I PËRCAKTUAR;**
- G. KOHËZGJATJA, NË QOFTË SE ËSHTË E PËRCAKTUAR;**
- H. TË DHËNAT E IDENTIFIKIMIT TË PERSONAVE PËRGJEGJËS PËR ADMINISTRIMIN DHE PËRFAQËSIMIN E SHOQËRISË NË MARRËDHËNIE ME TË TRETËT, KOMPETENCAT E PËRFAQËSIMIT, SI DHE AFATET E EMËRIMIT TË TYRE.**



- I. SPECIMENET E NËNSHKRIMIT (FIRMAVE) TË PERSONAVE, QË PËRFAQËSOJNË SHOQËRINË PËRPARA TË TRETËVE.**

DOKUMENTACIONI PËR PUNËMARRËSIT

Sipas legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e punës, punëdhënësi është i detyruar të ketë domosdoshmërisht në vendin e punës dokumente për punëmarrësit, të tilla si:

- Kodin e Punës dhe çdo ligj tjetër që rregullon të drejtat dhe detyrimet midis punëmarrësve dhe punëdhënësve, të cilat duhet t'ua vendosë në dispozicion të gjithë punëmarrësve;
- Kontrata individuale të punës;
- Regjistër për të punësuarit;
- Listë pagash;
- Leje pune për të huajt (kur ka punëmarrës të huaj, duhet të kujdeset për pajisjen e tyre me leje pune, vizë pune dhe leje qëndrimi për të punësuarin);
- Autorizim për punësim të të miturve;
- Çdo dokumentacion tjetër që lidhet me zbatimin e detyrimeve ligjore që burojnë nga marrëdhënia e punës.



**A Guide to Employer
Obligations**





**A Guide to Employer
Obligations**

Sipas kodit të punës, punëdhënësi duhet të mbajë në ndërmarrje edhe dokumente që kanë të bëjnë me shëndetin dhe sigurinë në punë, të tilla si:

- Kopje të deklaratave për aksidentet në punë, të cilat datojnë deri në tre vjet përpara datës së inspektimit nga inspektori i punës
- Planin, projektin e vendeve të punës
- Dokumentin e vlerësimit të riskut për çdo vend pune, të shoqëruar me masat parandaluese
- Listë për lëndët e rrezikshme që përdoren në ndërmarrjen e tij. (Kjo listë duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme, që lejojnë njohjen e përbërjes së substancave të përdorura, rrezikshmërinë, masat mbrojtëse, si dhe numrin e punëmarrësve që punojnë me to.)
- Dokumentacion të mjekut të ndërmarrjes
- Dokumentacion plotësues lëshuar nga autoritete publike përkatëse në fushën e shëndetit dhe sigurisë
- Leje ushtrimi profesioni
- Dëshmi të aftësisë për drejtimin/përdorimin e makinerive/pajisjeve që kërkojnë njohuri të specializuara.

Dokumentacioni i lartpërmendur nuk është shterues dhe mund të lindë nevoja për t'u plotësuar me dokumente shtesë, në varësi të llojit të aktivitetit.

KONTRATA TË NDRYSHME



Aktivitetet tregtare, në varësi të kompleksitetit dhe dimensionit të tyre, thuajse kurdoherë kanë nevojë për ambiente fizike të mëdha, në mënyrë që të kenë mundësi të ushtrojnë veprimtarinë për të cilën janë krijuar. Në këtë mënyrë, shoqëria duhet të lidhë kontratën e qirasë me pronarin e truallit/kapanonit. Ambientet mund të merren edhe në huapërdorje ose në forma të tjera dhe në të gjitha rastet palët duhet të përfundojnë kontratën përkatëse.

Nga ana tjetër, për të gjitha shitjet, furnizimet ose marrëdhënie të tjera juridike-kontraktore të caktuara me të tretët, shoqëria duhet të ndjekë të gjithë hapat ligjorë, që përbëjnë parakusht për të lidhur një kontratë.

Kontrata duhet të ketë të gjitha elementet që kërkon ligji dhe duhet të jetë së paku në formë shkresore.

KONTRATA SIGURIMI



Gjatë jetës së saj, kompania kryen një sërë aktiviteteve dhe vepron në disa drejtime për të realizuar qëllimet e aktivitetit të saj. Në këtë mënyrë, më poshtë gjenden disa nga llojet e kontratave të sigurimit, vullnetare ose të detyrueshme të cilat ajo duhet të lidhë për të siguruar në nivele të larta veprimtarinë e saj të biznesit:

- Sigurimi i detyrueshëm nga përgjegjësia për dëmet e shkaktuara ndaj palëve të treta nga përdorimi i mjeteve motorike (MTPL, i cili është i detyrueshëm sipas ligjit 32/2021)
- Sigurimi i përgjegjësisë profesionale të drejtuesve dhe administratorit të shoqërisë (Directors & Officers liability insurance)
- Sigurimi KASKO i mjeteve motorike
- Sigurimi i pronës nga zjarri, rrufeja, shpërrthimet dhe përplasjet e mjeteve ajrore apo pjesëve të tyre (FLEXA)
- Sigurimi nga ndërprerja e biznesit
- Sigurimi i përgjegjësisë së punëdhënësit
- Sigurimi i përgjegjësisë që rrjedh nga të metat e produktit
- Sigurimi i përgjegjësisë profesionale, në varësi të fushës në të cilën subjekti zotëron ekspertizë
- Sigurimi i shëndetit, sigurimi i jetës së të punësuarve;

LEJE, LICENCA, AUTORIZIME NGA INSTITUCIONET PUBLIKE

Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, por në skenarë të caktuar, ligji mund të kërkojë pajisjen e subjektit me një akt të organeve publike, që i lejon të kryejë një veprimtari apo një veprime të caktuara.

Subjektet kanë detyrimin që së paku, të regjistrohen në regjistrin tregtar përpara fillimit të aktivitetit. Me marrjen e certifikatës së regjistrimit nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), kompania mund të fillojë menjëherë ushtrimin e aktivitetit tregtar.

Kur aktiviteti i një kompanie ka për objekt kryerjen e veprimeve specifike, ose përdorimin e një të mire publike, për të cilat ligji kërkon pajisjen me licencë, leje apo autorizim, atëherë subjekti i nënshtrohet sipas rastit, procedurave të licencimit, autorizimit apo lejimit. Autoriteti lëshues për këto akte administrative është si rregull QKB-ja dhe në raste të veçanta, kompetente janë organe të tjera publike që përcaktohen nga ligje të posaçme.

Kategoritë e licencave, lejeve apo autorizimeve janë të parashikuara në *Shtojcën 1* të ligjit 10081/2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet” dhe zgjerohen më tej në Aneksin nr.1 të VKM-së nr.538/2009, e dalë në bazë dhe për zbatim të ligjit të mësipërm.



Shembull 1.

Shoqëria XYZ sh.a. kërkon të ushtrojë veprimtarinë e shërbimit privat të sigurisë fizike. Ndonëse ka kryer me sukses regjistrimin pranë QKB dhe është pajisur me certifikatën e regjistrimit, shoqëria XYZ duhet të pajiset me licencat respektive të (i) shërbimeve të ruajtjes së personave, objekteve e veprimtarive, (ii) shërbimeve të ruajtjes, transportimit e shoqërimit të vlerave monetare e sendeve të çmuara dhe (iii) Qendrës së trajnimit privat të punonjësve të shërbimit privat të sigurisë fizike. Shoqëria mund të aplikojë për të tre tipet e mësipërme të licencave, ose mund të zgjedhë midis tyre, në varësi të fokusit të saj. Këto tipe të licencave janë pa afat dhe ashtu sikurse u përmend, duhet të merren përpara fillimit të ushtrimit të aktivitetit.

Shembull 2.

Shoqëria YXZ sh.p.k. ka për objekt të veprimtarisë së saj prodhimin e materialeve të ndërtimit, të profileve të hekurit dhe strukturave të ngjashme për ndërtime shumëkatëshe.

Pas regjistrimit, konstatohet se objekti i shoqërisë përfshin përdorimin e një të mire publike siç është mjedisi. Në këto kushte, shoqëria duhet të pajiset me lejen përkatëse të mjedisit, sipas llojit dhe volumit të veprimtarisë ndikuese në mjedis.

REGJISTRIMI DHE VLEFSHMËRIA E OBJEKTEVE TË PRONËSISË INDUSTRIALE

Kompanitë, por jo vetëm, kanë të drejtë sipas ligjit të mbrojnë çdo krijim, imazh unik apo shenjë, fjalë, zgjidhje a produkte të ngjashme që përmbushin sipas rastit kushtet e markave tregtare dhe të shërbimit, patentave dhe modeleve të përdorimit, disenjove industriale apo të treguesve gjeografikë.

Ligji 9947, datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore përkatëse ofrojnë të gjithë kuadrin normativ për mbrojtjen e objekteve të pronësisë industriale.

Fusha e zbatimit të pronësisë industriale shtrihet në industri, tregti, bujqësi, si dhe në zhvillimin e të gjitha produkteve natyrore ose të përpunuara.

Duke qenë se kompanitë kanë në fushën e veprimit të tyre një gamë të gjerë aktiviteteve, rekomandohet që të kërkojnë mbrojtje për të gjitha objektet e pronësisë industriale që posedojnë.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) është autoriteti kompetent i ngarkuar me ligj për regjistrimin, administrimin dhe promovimin e objekteve të PI-së,



detyrim që i buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nga ligji organik nr. 9947, dt 07/07/2008 “Për pronësinë industriale” i ndryshuar, neni 189, si dhe nga dokumente strategjike si: Marrëveshja e Asociim-Stabilizimit në nenin 73 të saj, “Pronësia Intelektuale”.



FALEMINDERIT